

**INFORMACIONI PËR NDËRVEPRIMIN ME MJEDISIN  
PËR AKTIVITETIN MINERAR SHFRYTËZIM GURI GËLQERORË  
(Gure Dekorative) ME KARIERË ZONA MINERARE Nr. 62/7  
OBJEKTI “ZOGJAJ”  
QARKU DIBER**

*(Sipas Vendimit nr. 686 datë.29.07.2015)*



INVESTITOR : “PI. OR QUARRIES” sh.p.k

PROJEKTUES : « STUDIO PROJEKT » shpk

**MAJ 2015**

## ***Informacioni për ndërveprimin me mjedisin***

### ***1. PERSHKRIMI I PROJEKTIT***

- a. Nje pershkrim te shkurter te mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet projekti te shoqeruar me imazhe te marra jo me vone se 6 muaj nga data e aplikimit*
- b. Informacion per pranine e burimeve ujore ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te saj .*
- c.Nje indetifikim te ndikimeve te mundeshme negative ne mjedis te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet,uje,toke,ajer;*
- ç.Nje pershkrim te shkurterper shkarkimet e mundeshme ne mjedis, te tilla si: ujra te ndotura,gaze dhe pluhur,zhurme,si dhe prodhimin e mbetjeve;*
- d. Informacion per kohezgatjen e mundeshme te ndikimeve negative te indentifikuara*
- dh. Te dhena per shtrirjen e mundshme hapesineore te ndikimit negativ ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike ngavendodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te.*
- e. Mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te siperfaqes te mjedisit te ndikuar ne gjendin e meparshme ,perfshire edhe token bujqesore,si dhe kostot financiare te peraferta per per rehabilitimin.*
- ë. Masat e mundeshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negativene mjedis. .*
- f. Ndikimet e mundeshme ne mjedisin nderkufitar(nese projekti ka natyre te tille.)*

## ***Informacioni për ndërveprimin me mjedisin***

### **Hyrje.**

Informacioni për ndërveprimin me mjedisin të projektit hartohet në zbatim të vendimit Nr. 686 nr. 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjesive e të afateve për zhvillimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurave të transferimit të vendimit të Deklaratës Mjedisore”.

- a. Shoqëria Subjekti **PI. OR QUARRIES** ka marrë pjesë në konkurrimin e zhvilluar më 21.12.2016 dhe në datën 23.03.2017 me shkresën me Nr 677/2 Prot është njoftuar nga MEI si fitues i këtij konkurrense dhe ka fituar të drejtën e përgatitjes së dokumentave përkatës për pajisjen me leje minerare shfrytëzimi në zonën konkurrense Nr 62/7,
- b. Zona nr **62/7** si dhe zonat e tjera konkurrense, është publikuar për procedurë konkurrimi sipas Ligjit Nr.10304, datë 15.04.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, pikës 5 dhe pikave 7/7 e 7/8 të VKM nr. 320, datë 21.04.2011 “Për miratimin e procedurave e të kritereve të konkurrimit dhe të afateve të shqyrtimit të kërkesave për marrjen e lejeve minerare në zonat konkurrense”, Urdhrit nr 107. datë 10.03.2014 të Ministrit të Energjisë dhe Industrisë “Për miratimin e Planit Vjetor Minerar 2014”
- c. **Nje pershkrim te shkurter te mbuleses bimore te sipërfaqes ku propozohet projekti te shoqeruar me imazhe te marra jo me vone se 6 muaj nga data e aplikimit**

Për nga origjina, perberja dhe veçoritë gjeobotanike bimesia e Shqipërisë bën pjesë në nënzonën floristike mesdhetare e cila përfaqësohet në një njësi me të madhe, në zonën holarktike. Ndikim të madh në zhvillimin e floras mesdhetare ushtroi ftohja e përgjithshme e klimës në periudhën e pleistocenit dhe akullzimi i fuqishëm që pasoi atë. Tiparet karakteristike të bimesisë mesdhetare si për sa i përket veçorive gjeobotanike ashtu edhe përberjes morfologjike dhe shtrirjes vertikale të saj, janë karakteristike edhe për bimesinë e vendit tonë. Por kushtet konkrete të zhvillimit, sidomos të klimës dhe të relievit kanë përcaktuar edhe veçoritë origjinale të floras së Shqipërisë. E gjithë kjo pasuri floristike i detyrohet veçorive të evolucionit paleogeografik të Shqipërisë dhe sidomos larmisë së madhe të klimës, copetimit të theksuar të relievit dhe formave të shumëllojshme të tij, formacioneve të shumta shkembore (karbonatike, magmatike, terrigjene) etj.

Në rajonin ku bën pjesë zona minerare nr.62/7 zoteron bimesia e tipit mesdhetar. Rriten kryesisht drurë dhe sidomos shkurre me gjethe gjithmone të blerta, që zakonisht shoqërohen nga bime barishtore mesdhetare, pak a shumë të tipit kserofit dhe me një përqindje të lartë (rreth 65%) të formave jetësore terofite.

Në fotot e mëposhteme po paraqesim disa përfaqësues të bimesisë në zonë.



***Informacioni për ndërveprimin me mjedisin***



*Dushk që rritet në zone*





## *Informacioni për ndërveprimin me mjedisin*



Dellinje qe rritet ne zone

Fitocenozat e bimesise barishtore shume te larmishme nga perberja e llojeve, gjenden ne te gjitha zonat fitokilmatike te Shqiperise. megjithese fitocenozat barishtore nga ana e fizionomise ne pergjithesi duken relativisht te peraferta, ato ndryshojne midis tyre nga perberja floristike ne varesi te faktoreve ekologjike. Me perjashtime te pakta, gati ne te gjitha fitocenozat dhe bashkeshoqerimet barishtore gjenden perfaqesues te familjes graminore ( Graminaceae).



*Perfaqesues te familjes graminore qe rriten ne zone*

Bimesia qe rritet ne rajon eshte bimesi qe i pershtatet kushteve te klimes se rajonit, brezit te dushkut , me karakteristike qe rriten ne zone jane:

## ***Informacioni për ndërveprimin me mjedisin***

### **Dushk (quercus)**

Drure , rrale shkurre. Druret me palce yndyrore peskendeshe. Sythet vezengjashem , gjethet te vrigulluara ose te dhembzuara, rrale te plota , renese ose te perhereblerta. Cdo lule rrethohet nga nje peshtjelle qe drunjezohet dhe shoqeron lendet. Dushku gjendet ne disa forma si dushk, lis, qarr etj , ka perdorim gjethet e tyre, lendet kryesisht ushqim per blegtorine, gjithashtu perdoret edhe per ngrohje.

### **Dellinje (juniperus)**

Shkurre ose drure monoike ose dioike, gjethet te qendrueshme, halore ose mellugore, te perkunderta ose ne qethuj nga tre. Lulesas mashkull skajore ose sqetulllore, vezake. Bocezat sqetulllore ose skajore, piqen vitin e pare, te dytin, ose te tretin, rruzullore ose vezengjashme, mellugat mishtake, te ngjitura ndermjet tyre. Rritet ne zone me pak lageshti, frutet e saj perdoren kryesisht ne industrine mjekesore dhe pijeve alkolike.

Persa i perket bimeve barishtore rritet

### ***lepjeta ( rumex)***

bime barishtore shumevjecare, rralle nje vjecare. Gjethet te kembyera, te fundit zakonisht e llape te madhe me bishtak, kercelloret e siperme shpesh pa bishtak. Lulet hermafrodite, rralle njeseksore, te vendosura ne qerthuj te rreme ose gjysmeqerthuj mbi lulesa te thjeshta.

### ***Rrepice ( rapistrum)***

Bime njevjecare me qime sidomos ne pjesen e poshtme. Kercelli deri ne 40 cm, mjaft i degezuar. Nenpetlat te ngritura, lulet te verdha te zbehta.

### ***shpender ( helleborus)***

bime barishtore shumevjecare me rizome. Gjethet e bazes te medha paksa kembake deri te gishtezuara. Lulesa ne cima. Lulet te medha. Fryti rreshekth me disa fara.

Si dhe disa bime barishtore te tjera.

Ne fshatrat perreth zones rriten edhe nje numer i konsiderueshem bimesh frutore si molle, ftonj, dardha, kumbulla etj.

Persa i perket flores ne zonen ku do shfrytezohet guri gelqeror si shihet edhe nga fotot e meposhtme ajo paraqitet e zhveshur , vende –vende rriten prrall dhe dushk te cilat nuk gezojne status te vecante ruajtje.

## **b.Informacion per pranine per pranine e burimeve ujore ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te saj.**

Nga rikonjicioni i kryer ne momentin e fillimit te studimeve dhe te materialeve gjeologjike te marra ne Sherbimin Gjeologjik rezulton se ne zonen minerare nr.62/7 nuk ka burime te ujrave

## ***Informacioni për ndërveprimin me mjedisin***

siperfaqesore pasi kjo zone perbehet nga formacione karbonatike te perfaqesuara nga gelqerore me nje mbulesa te vogel .

Vendburimi i gëlqerorit te mermerizuar Zogjaj, Peshkopi ndodhet në një pjesë të ngritur të zonës ndërmjet kuotave 770 m dhe + 870 m mbi nivelin e detit. Në perëndim është i rrethuar nga shistet e kuqe të cilët nën veprimin e agjentëve atmosferikë kanë bërë që terreni të jetë mjaft i aksidentuar me përroska dhe vithisje. Duke qënë një terren mjaft i thyer bën që ujrat nëntokësore që mund të ndodhen në zonë të jenë mjaft poshtë objektit në kuotën rreth 770 m ku rrjedhin edhe ujrat e përroit te Zogajt.

Në territorin e objektit për shfrytëzim nuk është takuar asnjë burim natyral i ujrave.

Ekzistenca e lumit te Zogjat në nivel mjaft të ulët të rrjedhshmërisë së ujrave bën që niveli i ujrave nëntokësore në objekt të zbrësë në kuotën e rrjedhjes së lumit.(+770m) Si përfundim ekzistenca e këtij lumi bën që vendburimi i gëlqerorit te mermerizuar Zogjaj Peshkopi të jetë i thatë nga pikpamja hidrike

### **c.Nje indentifikim te ndikimeve te mundeshme negative ne mjediste projektit,perfshire ndikimet ne biodiversitet,uje,toke,ajer;**

Siperfaqja ne te cilen do te behet shfrytezimi nuk duket nga qendrat e medha te banuara pasi zona eshte afersisht 1km larg ne vije ajrore , me perjashtim te rasteve te barinjeve qe kalojne prane.

Aktiviteti shfrytezimit me karriere prek perkohesisht peizazhin ekzistues dhe topografine e saj per gjate kryerjes se aktivitetit .

Me masat qe do merren per rehabilitimin e saj, gjelberimin me bime qe rriten ne zone, gjate shfrytezimit dhe ne mbyllje te aktivitetit , peizazhi dhe topografia e zones do te permiresohet dukshem do te krijohet nje ambjent panoramik i kendshem per syrin e njeriut dhe çlodhes.

Dëmtimi i vegjetacionit bimor, sidomos gjatë hapjes se karrieres dhe shfrytezimit te shkalles se pare dhe te dyte është faktor negativ.

Per nga pikpamja hidrologjike dhe hidrografike objekti i kerkuar ndodhet ne kushte te mira. Nuk vihen re burime natyrale ujrash. Pikerisht ne vendin ku kerkohet te shfrytezohet nuk ka prroska. Kur ka reshje, neper te rrjedhin me rrembim ujra siperfaqesore per shkak dhe te pjerresise mjaft te madhe te terrenit.

Persa i perket zbatimit te ketij projekti ndikim negativ do te kete ne ndryshimin e topografise se tokes .

Persa i perket cilesise se ajrit ne zone ai konsiderohet me parametra te pranueshem duke qen se ndodhet larg zonave te banuara dhe nuk eshte i ndotur nga veprimtarite e industrise. Edhe



## ***Informacioni për ndërveprimin me mjedisin***

zhvillimi i aktivitetit të shfrytëzimit nuk do të shkaktoj ndotje të ajrit sepse nuk do të ketë emetime të gazeve ndotes.

**ç.Nje pershkrim te shkurter per shkarkimet e mundeshme ne mjedis, te tilla si: Ujera te ndotura,gaze dhe pluhur,zhurme,si dhe prodhimin e mbetjeve;**

*Administrimi i mbetjeve dhe ujerave te ndotura urbane*

Zona ku do zhvillohet aktiviteti është në largësi nga zona me e afërt e banuar. Mbetjet urbane që do të krijohen nga aktiviteti i përditshëm i punonjësve do të depozitohen në kontener plastik të vecantë dhe me pas do të evadohen drejt vend depozitimeve të caktuara. Përsa i përket ujerave të përdorura ato sistemohen , ndërsa pjesa e tualeteve është zgjidhur me gropë septike.

Për sa i përket shkarkimeve të gazeve ato do të jenë mospërfillesh se në punë do të jete një eskavator,fadrome dhe një makinë transporti **kurse përdorim të lendeve plasese nuk do të ketë.**

Pluhurat në këto aktivitet do të jenë fare të pakta pasi pluhura do të ketë në rruget e transportit brenda karrierës por që është menduar të sperkatet me ujë në periudhën e verës kur thatësira është me e madhe.

***Zhurmat ne fazen e ndertimit kryesisht vijne :***

- nga makinerit e përdorura për pastrimin e dheut të sheshit të montimit të kontoniereve, shtrimin e sheshit me cakell, shkarkimin nga makina me vinç e kontoniereve.
- nga makinerit që do përdoren për përgatitjen e shesheve të shkalleve të shfrytëzimit të karrierës.

Gjatë fazës së parë të ndërtimit paisjet e përdorura do të jenë një eskavator që do të hap shkallet e karrierës dhe makinerit që do të përdoren për montimin e kontoniereve me kohë teper të kufizuar punë deri dy dite si kamioni transportit të kontoniereve, vinci shkarkimit dhe fadroma e pastrimit dhe shtrimin të sheshit të kontoniereve.

***Zhurma gjate fazes se shfrytezimit***

Ndikim të zhurmave do të ketë gjatë procesve të punës së shfrytëzimit.

Niveli i zhurmave të këtyre makinerive , është i atij niveli që nuk influencën si për të punësuarit dhe për banorët dhe gjallesat për rreth tij.

Niveli i zhurmave nga puna e njëkohëshme e makinerive në distancë 7 m nga to, është me i vogël se 70 dB. Duke marrë parasysh shprehjen e nivelit të intensitetit akustik të një zhurme me relacionin e mëposhtëm :

**$L = 10 \lg(I_1/I_0)$**  ku

**$L$**  - Niveli akustik i zhurmës të marrë në konsideratë .

**$I_1$**  - Intensiteti akustik i zhurmave



## ***Informacioni për ndërveprimin me mjedisin***

**$I_0$**  - Intensiteti akustik i references

Vleresojme se niveli akustik i zhurmes ne rruge eshte me i ulet se ai i zhurmes se nje makine qe kalon ne te, praktikisht ai eshte 40-50 dB qe i pergjigjet kushteve te nje bisede me ze normal.

Fenomene te tilla si vibracion, ndricim, nxehtesia jane te paperfillshme ne zhvillim te ketij aktiviteti ne kete objekt. Duhet theksuar qe vibracioni ne kete aktivitet nuk ndikon ne territor mbasi nuk ka objekte te te cilat ndihet influenza e minave.

Siç thame edhe me siper, zhurmat qe do te krijohen gjate procesit te punes ne objekt jane vetem ato te shkaktuara nga makinerite e shfrytezimit ,te ngarkimit e te transportit te cilat ato jane brenda normave

### ***Depozitimet e sterileve***

Ne vendet e caktuara ne projekt (depozitat e sterileve) parashikohet depozitimi i materialit te paperdorshem dhe perpunimi i tij me toke vegjetale per te mundesuar mbjelljen e bimeve dhe pemeve karakteristike te zones gjate fazes se rehabilitimit. Dherat e depozituara ne damba do te perpunohen me dhera te pasuruara me humuse, do te transportohen dhe shperndahen ne sheshet e shkalleve me trashesi mbi 20 cm dhe do te pyllzohen me bime qe riten ne zone per gjelberimin e saj.

### **d,Informacion per kohezgjatjen e mundeshme te ndikimeve negative te identifikuara**

Ndikimet negative si gjelberimi i zones qe do te preket nga shfrytezimi do te zgjase pasi aktiviteti minerare eshte planifikuar te zgjase per 25 vite por me programin qe do te behet mendojme te kalojme ne rehabilitim progresiv ne shkallet e siperme dhe kjo mund te filloje ne vitin e peste te lejes.

Kurse per sa i perket zhurmave megjithese ato jane te pa perfilleshme ato do te zgjasin per gjithë periudhen 25 vjeçare te jetes se karrieres.

### **Dh. Te dhena per shtrirjen e mundshme hapesinore te ndikimit negative ne mjedis, qe nenkupton distancën fizike nga vendodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te**

Duke njohur teknologjine, operacionet ne terren dhe menyren e shfrytezimit te objektit u identifikuan ndikimet e mundeshme negative ne çdo receptore - perberes te mjedisit ne objekt.

**Indetifikimi i ndikimeve** – Permes te cilit u percaktua ndërveprimi mjedis-projekt i prodhimit te gurit gelqerore ne vendburim dhe u identifikuan ndikimet e mundeshme gjate kesaj faze sipas receptoreve te mjedisit.

**Vleresimi i ndikimeve** – Ekspertet mjedisore te fushave te ndryshme bene perpjekje per matjen e gravitetit te ndikimeve . Vleresimi i Sinjifikances ka te beje me vete rendesine e ndikimeve dhe eshte faza me e rendesishme per zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe parafron ate me objektivisht me teresine e bashkeveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret

## ***Informacioni për ndërveprimin me mjedisin***

e perdorur per vleresimin e rendesise se ndikimeve variojne dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit te ndikuar.

**Shtrirja fizike-** Vlereson siperfaqen apo dimesionin hapsinore te nje ndikimi te dhene ne raport me burimin qe gjeneron ate ndikim, p.sh. ndikimi ne toke nga shfrytezimi eshte nje ndikim saktesisht i percaktuar i cili mund te matet , por ne se do te ket erozion te tokes ndikimi rritet ne permasa fizike te siperfaqes se marre per studim.

- **Kohezgjatja e ndikimit** – Vlereson se sa do te zgjase nje ndikim i caktuar ne dimesionin kohe (ndikim i perhershem apo i perkoshem). Ne rastin tone shfrytezimi i gurit gelqerore eshte e perhereshme per nje periudhe 25 vjecare qe perkon me afatin e lejes minerare. Ndersa te gjitha ndikimet e tjera negative ne mjedis jane te perkoshme, si shkarkimet e ujit te rreshjeve, gjelberimit , etj

-**Kthyesmeria** –Vlereson mundesin e kthimit te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e tij te me pareshme (aftesia per tu rehabilituar dhe regjeneruar )

-**Rendesia** – Realizon nje vleresim total te tre permasave te mesiperme dhe njekohesisht thekson vemendjen qe duhet patur per administrimin e ndikimit.

Ndikimet e parashikuara nuk kane shtrirje te madhe fizike, objekti i shfrytezimit ndodhet ne distance te konsiderueshme nga zona me e afert e banuar dhe nuk preket nga zhvillimi i ketij aktivitetit. Zhurmat qe krijohen gjate hapjes dhe shfrytezimit te shkalleve te karieres nuk perbejn ndotje akustike. Analiza e frekuences te zhurmes te emetuar nga keto makineri dhe pajisje tregon se ato ndodhen nen mesataren e frekuences 100 – 150 Hz , e cila eshte e pranueshme nga veshi i njeriut . Koha ne te cilen do te jene te pranishme keto zhurma eshte vetem gjate dites, meqenese ne objekt do punohet vetem me nje turn. Niveli i zhurmave te ketyre mjeteve ne largesi nuk do te jete i madh dhe do te jete konform normave ne fuqi.

**e.Mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te siperfaqes te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e meparshme ,perfshire edhe token bujqesore,si dhe kostot financiare te peraferta per per rehabilitimin.**

Zona minerare nr.62/7nuk perfaqeson toke buke por mase shkembore me nje mbulesa e tipit toke vegjetale

Siperfaqet qe do te preken nga aktiviteti minerare si rruge jashte siperfaqes se karieres por brenda zones minerare nr. 62/7 ,siperfaqja qe do shfrytezohet si dhe sheshin e depozitimit te sterileve nje siperfaqe e pergjitheshme prej 048 hektare eshte planifikuar te rehabilitohet ku me poshte po japim te detajuar siperfaqet dhe koston e rehabilitimit per kete aktivitet.

## ***Informacioni për ndërveprimin me mjedisin***

### **-Masat rehabilituese**

Punimet që do të kryen për rehabilitimin e zonës së shfrytëzuar

-Punime inxhinierike

-Punime biologjike

### **-Punime inxhinierike**

-Hapja dhe mirembajtja e rrugëve automobilistike për hyrje në sheshin e sigurisë së shkalleve

-Hapja e kuletave dhe kanaleve për drenazhim dhe disiplinimin e ujërave të rreshjet atmosferike

### **-Punime biologjike**

-Mbushja me dhëra humusore me trashësi 30cm të shesheve të shkalleve dhe përgatitja e tokës për mbjellje me bimesë.

-Mbjellja e bimesës.

-Sherbimet profilaktike në sipërfaqet e rehabilituara.

### **Rehabilitimi i territorit**

Masat rehabilituese do të konsistojnë në :

-Uljen e erozionit

-Restaurimin e habitateve

-Pasurimin e biodiversitetit me speciet natyrore.

-Rritjen e vlerave vizuale dhe rikrijuesë të territorit që do të shfrytëzohet.

Së pari shfrytëzimi me taracë me lartësi 10 m, është bërë për të lehtësuar zbatimin e planit të rehabilitimit. Këto taraca do të lejojnë si mbulimin e sipërfaqes me gjelberim ashtu edhe evitimin e pamjeve të pakëndeshme të shpatëve vertikale të tarracave që mund të mbeten zbuluar në rastet e lartësive së përgjithshme të tarracës rreth 10 m.

Rradha e mbjelljeve do të jetë nga lart-poshtë, duke lejuar mundësinë për vetëpërhapjen e specieve mbi bazat e aktivitetit eolik dhe forca të rëndësishme. Gjërësia e shkallës së taracës do të jetë 4m. Kjo lloj mbjellje lejon vetëpërhapjen e specieve, si dhe nuk demton në rritjen e bimeve pasi nuk pengon dritezimin.

### **Rehabilitimi i tokës**

Për rehabilitimin e tokës, do të shfrytëzohen mbetjet e imeta nga materiali i nxjerrë dhe do të plotësohet me 10 cm dhëra humusore të pasur me pleh.

Nëse do të nevojitet stabilizimi i këtij dheu një pjesë e faqes së pjerrët do të bëhet me trungje të ngulura me thellesë 30 cm, mulcirim do të jetë i thatë dhe me kashtë, gjethë të bimeve të zonës dhe dege. Mulcirim do të shërbejë si për uljen e humbjeve të farnave nga largimi prej aktivitetit eolik, ashtu dhe për uljen e aktivitetit erodik për sa kohë vegjitacioni është i pa zhvilluar mirë. Mbjelljet do të kenë renditjen me largësi fidanesh cdo 10 m, gjë që do të japë një kurorë dendësi mjaft të mirë të territorit pas shfrytëzimit, dhe lejon dritezimin për vetëritjen dhe zhvillimin e bimeve natyrore.



## ***Informacioni për ndërveprimin me mjedisin***

Siç është theksuar edhe me sipër shfrytëzimi i këtij objekti do të bëhet me kariere

Perfundimi i shfrytëzimit të këtij objekti pas 10 vitesh pritet të leje gjendjen e mëposhteme :

Per periudhën e parë prej 25 vitesh sipërfaqet që do të përdoren për depozitim sterili do të jenë:

1. Sipërfaqja rrugësh auto 1300 m<sup>2</sup>

Per periudhën e parë prej 25 vitesh sipërfaqet që do të nënshtrohen shfrytëzimit do të jenë :

1. Për pjesën mbi rrugë nga kuota +850 deri në kuotën +880m . Parametrat e mëposhtëm janë për zhvillimin e karrierës deri në kuotën +880m, **1.34 ha**;
2. Për pjesën nën rrugë nga kuota +850 deri në kuotën +800m. Parametrat e mëposhtëm janë për zhvillimin e karrierës deri në kuotën +850m, **4.28 ha** ;

### **Punimet e mbylljes trajtimit të sterile dhe rehabilitimit të zonës**

Në nenin 4.1 u përshkrua gjendja e prishme e minierës pas përfundimit të shfrytëzimit . Elementet e mësipërme janë marrë në konsideratë në hartimin e projektit të mbylljes dhe llogaritjen e shpenzimeve përkatëse për realizimin e tij dhe përkatësisht

- Tre stoke sterile me një sipërfaqe prej 0.48 ha
- Sipërfaqet e shfrytëzuara të karrierës prej 5.62 ha
- Një sistem rrugësh të brendshme të përdorura gjatë shfrytëzimit të objektit që përfshihen brenda sipërfaqes së zonës dhe do të nënshtrohen shfrytëzimit me sipërfaqe 0.13 ha
- Objekti në përfundim do të shoqërohet me punime drenazhimi dhe kullimi të tipit kanal i ujërave të larta (KUL)
- Në përfundim do të jetë i shoqëruar nga sinjalistika përkatëse edhe rrethimi

### **4.3 Preventivi i shpenzimeve dhe llogaritja e garancive për mbyllje dhe rehabilitim**

Plani përfundimtar i mbylljes dhe rehabilitimit mjedisor pas përfundimit të aktivitetit mineral të shfrytëzimit të gelqerorit të mermerizuar në zonën minerar konkurruese Nr 62/7 Zogjaj rrethi i Dibres , Qarku Diber hartohet në zbatim të Udhezimit Nr 718, datë 03.10.2011 “ Për mënyrën e vlerësimit të garancive financiare të lejeve minerare”

Aneksi 4 “ Menyra e vlerësimit të garancive për realizimin e e planit të rehabilitimit për lejet minerare e shfrytëzimit dhe kërkim-zbulim shfrytëzimit”

Pika 2 Për shfrytëzimin sipërfaqësor, nenpika b Preventivi tip i planit të rehabilitimit të një 1 ha kariere për grupin e materialve të ndërtimit .

## ***Informacioni për ndërveprimin me mjedisin***

Ky plan perfundimtar mbyllje dhe rehabilitimi ka per qellim marrjen ne konsiderate te gjendjes perfundimtar te parashikuar ne projekt dhe shqyrtimindhe parashikimin e shpenzimeve te domosdoshme per mbylljen dhe rehabilitimin e pas shfrytezimit te objektit te gelqeroreve te mermerizuar ne zonen konkuruese Nr 62/7 ne objektin “Zogja” nga subjekti privat “PI.OR QARRIES”sh.p.k

Ne tabelat e meposhteme jane dhene llogaritje perkatese per realizimin ete gjitha proceseve perkatese te parashikuar ne preventivin tip

1. Shpenzimet per kryerjen e proceseve perkatese per mbylljen trajtimin e sterileve dhe rehabilitimin e siperfaqesse tyre prej 0.48 ha jane **154920 leke**
2. Siperfaqja e pergjithshme horizontale e shfrytezuar e karrieres, qe do te trajtohet eshte 5.26 ha dhe shpenzimet per rehabilitimin e saj rezultojne **1813855leke**
3. Siperfaqja e pergjithshme horizontale e rrugeve te karrieres, qe do te trajtohet eshte 0.13 ha dhe shpenzimet per rehabilitimin e saj rezultojne **41958leke**
- 4.
5. Shuma e pergjitheshme per mbylljn edhe rehabilitimin e karrieres do te jete **2010733 lek**
6. **Garancia vjetore e rehabilitimit do te jete 80429 leke /vit**

### **ë.Masat e mundeshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negativene mjedis.**

Per te bere shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negativene mjedis shoqeria do te beje ne menyre te vazhdueshme monitorimin e aktivitetit nga eksperte te specializuar dhe do te raportoje ne agjensine rajonale te mjedisit te qarkut ne Agjensine Kombetare te Mjedisit si dhe ne Ministrine e Mjedisit

Qellimi i monitorimit mjedisor per veprimtarine e projektit te zbatuar eshte qe te siguroje te dhena nepermjet te cilave te vleresohet ne se operimi i veprimtarise eshte ne perputhje me ligjet dhe standartet mjedisore qe lidhen me te, si dhe per te vleresuar performancen mjedisore te menaxhimit te saj ne kuader te permirosimit te vazhdueshem.

Monitorim i zhurmave te mjeteve te ngarkim-transportit ne fazen e hapjes se karrieres, shfrytezimit dhe gjate transportit prane qendrave te banuara.

Monitorimi i sjelljes se bimesise se zonen rreth karrieres ne nje distance me rreze 200 ml.

Monitorim i pluhurave ne proceset e zbulimit, hapjes se rrugeve, gjysem transheve dhe nxjerrjes se mineralit ne kariere dhe gjate transportit,vecanerisht ne rruget e pa asfaltuara.

Monitorimi i gjendjes se paisjeve e makinerive, vecanerisht mjeteve te ngarkimit dhe transportit dhe mundesise per rrjedhje dhe ndotje.

Monitorim i faktoreve qe shkatojne fatkeqesi natyrore dhe humane

Monitorim i sjelljes se bimesise se mbjelle gjate rehabilitimit ne shkallet e shfrytezuara dhe sjellja nga shfrytezimi ne shkallet e pa shfrytezuara.

### ***Informacioni për ndërveprimin me mjedisin***

Indikatorët e mesiperm të monitorimit janë një ndërthurje treguesish me të cilët vlerësohet trysnia që ushtron zbatimi i këtij projekti në mjedis si dhe gjendja e mjedisit, ndikimit e ndertimit dhe funksionimit të projektit të zbatuar në këto objekt.

Matja dhe mbledhja e të dhënave për treguesit e mesiperm do të bëhet konform metodave dhe teknikave shkencore të njohura dhe të pranueshme.

Të dhënat që do të mblidhen do të vihen në dispozicion të organeve shtetërore dhe të interesuarve të tjera, gjithashtu këto të dhëna do të analizohen me qëllim përmirësimit e performancës mjedisore të veprimtarisë dhe berjen e korigjimeve të nevojshme.

Për të ruajtur të dhënat mjedisore të veprimtarisë do të përgatitet dhe mbahet një regjistër i veçant ku do të hidhen vazhdimisht të dhënat mjedisore.

#### **f. Ndikime të mundshme në mjedisin nderkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë.)**

Zbatimi i këtij projekti nuk ka ndikim në mjedisin kufitare pasi kufiri me shtetet fqinje është shumë larg.

### **Informacioni për ndërveprimin me mjedisin të projektit u përgatit nga**

**“STUDIO PROJEKT” shpk, me autore:**

**Ekspert Mjedisori dhe ing. Minier.**

**Ing. Mjedisori**

**Xhevair DERMISHI**

**Arvena FEJZULLAI**





## ***Informacioni për ndërveprimin me mjedisin***



### **REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E MJEDISIT**

Nr. 331 Prot.

Tirane, me 09.09. 2004

Vendimi Nr.11, Nr.086Regj.

### **ÇERTIFIKATË**


Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.268, datë 24.04.2003 "Për çertifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

### ***Xhevair DERMYSHI***

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Ethem RUKA





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
Ministria e Zhvillimit Ekonomik,  
Tregtisë dhe Sipërmarrjes

## LICENCË



LN-0042-06-2009	NUIS/NIPT: K62021001S
Subjekti: STUDIOPROJEKT	
Adresa: TIRANE, TIRANE, TIRANE, RUGA FROSINA PLAKU (PERBALLË KLUBI PARTIZANI), 51/6	
Kodi: III.2.A (1+2)	Kod tjetër:
Data e lëshimit: 27/03/2014	Afati i vlefshmërisë: Pa afat
Kategoria	
Shërbime ekspertize dhe/jose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis	
Nënkategoria	
Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis	
Veprimtari specifike	
1. Ndikim në mjedis 2. Auditim mjedisor	
Specialiteti	

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor, vlerësimi i ndikimit në mjedis)

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nënshtkrimi i sportelit:

*Dajbna Stojà*

